



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 1667/2025

Lidhur me monitorimin e mbarëvajtjes së Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më 12 tetor 2025, të Zgjedhjeve Lokale Raundi i Dytë, të mbajtura më 9 nëntor 2025, dhe të Zgjedhjeve të Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025

Drejtuar:

Z. Kreshnik Radoniqi, kryetar
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Prishtinë, më 3 shkurt 2026

Qëllimi

Raporti pasqyron qëndrimet dhe vlerësimin e Avokatit të Popullit lidhur me mbarëvajtjen e procesit të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, raundit të dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 9 nëntor 2025, si dhe Zgjedhjeve të Përgjithshme të mbajtura më 28 dhjetor 2025.

Raporti paraqet vlerësimet e Avokatit të Popullit mbi respektimin e të drejtave zgjedhore të qytetarëve, vlerësime këto që janë bërë mbi bazën e informatave të mbledhura nga terreni gjatë monitorimit të procesit zgjedhor të tri palë zgjedhjeve nga ekipet vëzhguese të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), gjatë ditëve të zgjedhjeve, si dhe në bazë të ankesave individuale të pranuar.

Baza kushtetuese dhe ligjore

1. Në pajtim me nenin 132, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Kushtetuta më tej në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);*
 - *Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 1);*
 - *publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë (neni 16, paragrafi 15);*
 - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);*
 - *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avansimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5);*
 - *t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6);*

- *Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës (neni 18, paragrafi 3)."*

Instrumentet ligjore të aplikueshme

3. E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si e drejtë themelore civile dhe politike, është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Neni 45 i Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] përcakton: *"Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike."*
4. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në nenin 21 parasheh: *"Secili ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërsëdrejti ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht. Secili ka njësoj të drejtë të hyjë në shërbimet publike të vendit të vet. Vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhjet e herëpashershme dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe me votë të barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë."*
5. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 3 të Protokollit shtesë nr. 1 të Konventës shprehimisht përcakton: *"Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës."*
6. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25, pika b, përkitazi me të drejtën për zgjedhje parasheh: *"Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve."*
7. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokolli Opsional, në nenin 29 [Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike] garanton mbrojtjen e së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, e cila parasheh: *"Shtetet Palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër:*
 - (a) *Tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësi të kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur, ndër të tjera duke:*
 - (i) *Siguruar që procedurat, facilitetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për tu kuptuar dhe përdorur;*
 - (ii) *Mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të votuar me votë të*

fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, për të kandiduar në zgjedhje, për të ushtruar funksione publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive asistuese dhe të reja, ne rastet e përshtatshme;

(iii) Garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistenca në votim nga një person i zgjedhur prej tyre.

(b) garantimin e një ambienti, në të cilin personat me aftësi të kufizuar mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në dirigjimin e çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike, duke përfshirë:

(i) Pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike;

(ii) Krijimin apo pjesëmarrjen në organizata të personave me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.”

8. Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka përcaktuar qartë rregullat e organizimit të sistemit zgjedhor, duke përfshirë rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

9. Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 4 - Parimet themelore, përcakton:

“1. Mbajtja dhe administrimi i zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe legjislacioni përkatës zgjedhor udhëhiqen nga parimet në vijim:

1.1. zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e KQZ-së;

1.2. çdo shtetas i Republikës së Kosovës është i barabartë në ushtrimin e të drejtës për të votuar dhe për t’u zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

1.3. liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim;

1.4. zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës reflektojnë përfaqësimin gjeografik të të gjitha rajoneve të Kosovës; [...].”

10. Neni 6 [E drejta për të votuar] i Ligjit nr. 08/L-228, saktëson: *“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. E drejta e votës mund të kufizohet me vendim gjyqësor.”*

11. Lidhur me votimin brenda dhe jashtë vendit, ligji i lartpërmendur në nenin 7 [Votimi brenda dhe jashtë Kosovës], paragrafët 1 dhe 2, përcakton: “Çdo shtetas me të drejtë vote ka të drejtë të votojë në Kosovë në ditën e zgjedhjeve dhe në komunën ku ai apo ajo është i regjistruar, me kusht që emri i tij apo saj paraqitet në Regjistrin Qendror Civil. Shtetasi i Republikës së Kosovës, që jeton jashtë vendit, ka të drejtë të votojë në zgjedhje pas regjistrimit të suksesshëm sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj.”
12. Ky ligj, në vijim, lidhur me të drejtën e votës dhe fshehtësinë e votës, në nenin 89, paragrafët 1, 5 dhe 6, parasheh: “Votuesi më të drejtë për të votuar ka të drejtë vote nëse ai/ajo është i regjistruar në Kosovë ose ka aplikuar suksesshëm për votim jashtë Kosovës siç përcaktohet në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji [...]. Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi, me kusht që personi që ndihmon është votues në qendrën e njëjtë të votimit me votuesin. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV-së ose vëzhgues i akredituar, përjashtimisht për anëtarët e ngushtë të familjes. Për këtë lloj të votimit, KQZ do t'i caktojë kriteret me rregullën zgjedhore. Kryesuesi i Këshillit të vendvotimit obligohet që të shënojë në librin e votimit, rastet e votimit me asistencë, duke përfshirë arsyet konkrete dhe të shënojë të dhënat personale të votuesit dhe të dhënat personale të personit që ka ndihmuar.”
13. Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale për Republikën e Kosovës, në nenin 1 përcakton se qëllimi i këtij ligji është organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve për kuvendet e komunave dhe kryetarët e komunave të Kosovës.
14. Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale për Republikën e Kosovës, neni 3 [Parimet themelore], përcakton: “3.1 Mbajtja dhe administrimi i zgjedhjeve lokale në Kosovë dhe legjislacioni përkatës zgjedhor udhëhiqen nga parimet në vazhdim: - Zgjedhjet Komunale mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me rregullat e këtij ligji dhe rregullave të KQZ-së. - Votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar dhe për të hedhur numër të barabartë të votave në zgjedhjet e njëjta. - Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë për të votuar dhe të zgjidhet pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji. - Organet e administrimit të zgjedhjeve ndërmarrin aktivitete për edukimin e votuesve me qëllim të rritjes së aftësive të votuesve për procedurat e votimit dhe mbrojtjes së të drejtave zgjedhore. Për këtë qëllim, organet e administrimit të zgjedhjeve vejnë në dispozicion materialin në gjuhët e komuniteteve në ato zona gjeografike ku ato komunitete gjenden dhe përmes mediave që veprojnë në gjuhët minoritare. - Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengoj ndonjë qytetar për të votuar, ta detyroj atë të votojë në mënyrë të veçantë, të mbaj atë përgjegjësi për votën, ose të kërkojë, kundër dëshirës së tij/saj, që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mosvotim [...].”

Monitorimi i mbarëvajtjes së zgjedhjeve lokale dhe qendrore në vitin 2025 nga Institucioni i Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit, nëpërmjet përfaqësuesve të deleguar për monitorimin e procesit të

Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës, monitoroi mbarëvajtjen e Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, raundit të dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 9 nëntor 2025, si dhe Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës të mbajtura më 28 dhjetor 2025.

15. Monitorimi, veçanërisht, është fokusuar në aspektet si në vijim:

- a) nëse procesi i votimit ka filluar me kohë;
- b) nëse ka pasur raste që kanë cenuar rrjedhën normale të votimit;
- c) nëse qendrat e votimit kanë pasur qasshmëri infrastrukturore, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara;
- d) identifikimin e votuesve në regjistrin e votuesve në vendvotime;
- e) nëse janë respektuar rregullat e vendosjes së kamerave në vendvotime;
- f) mbarëvajtja e procesit të vëzhgimit nga vëzhguesit;
- g) nëse ka pasur parregullsi në procesin e votimit;
- h) nëse është respektuar ruajtja e fshehtësisë së votës dhe ruajtja e vullnetit elektoral të votuesve;
- i) nëse janë respektuar të drejtat e votimit të personave me nevoja të veçanta;
- j) mbarëvajtja e procesit zgjedhor në qendrat e ndalimit, të paraburgimit, në burgje, në spitale, në shtëpitë e të moshuarve etj.

Ankesat e pranuar në Institucion lidhur me pretendime për cenimin e së drejtës së votës

16. Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit:

- Më 9 nëntor 2025, pranoi Ankesën R.nr.1542/2025 të parashtruar nga V. Rr., kundër KQZ-së, lidhur me mohimin e votimit me asistencë të nënës së tij, e cila, sipas tij, është e moshës së shtyrë dhe nuk di shkrim-lexim.
- Më 9 nëntor 2025, pranoi ankesën R.nr.1595/2025, të parashtruar nga R. S., kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me pretendimet për parregullsi të shumta në procesin e votimit dhe të numërimit të votave në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025 në Komunën e Hanit të Elezit, përfshirë: votim me asistencë në përqindje të lartë; përfshirje të votuesve që gjendeshin në burg jashtë vendit; probleme me votimin e diasporës (mosdërgim i fletëvotimeve dhe votim i dyfishtë); mungesë transparence dhe njoftimi lidhur me numërimin e votave pa praninë e vëzhguesve; si dhe mosverifikim të këtyre pretendimeve nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Gjykata Supreme.
- Më 2 dhjetor 2025, pranoi Ankesën R.nr.1644/2025 të parashtruar nga S. B., kundër KQZ-së, lidhur me Udhëzuesin për Votimin me Asistencë, të hartuar nga KQZ-ja, me pretendimin se i njëjti krijoi praktika që cenuan të drejtat e personave me aftësi të kufizuara gjatë procesit zgjedhor në raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura më 9 nëntor 2025.
- Më 20 nëntor 2025, pranoi Ankesën R.nr.1653/2025 të parashtruar nga F. B., kundër KQZ-së, lidhur me mossigurimin e materialit për votim në zgjedhjet e mbajtura më 9

nëntor 2025, me pretendimin se ankuesi jetonte jashtë vendit, ishte i regjistruar për të votuar, por nuk e pranoi zarfin për votim përmes postës.

Vëzhgimi i Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025

17. Lidhur me vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale nga IAP-ja, të mbajtura më 12 tetor 2025, procesi i vëzhgimit u mbështet nga 19 ekipe të koordinuara monitoruese të zyrtarëve të IAP-së. Çdo ekip u caktua për qendrat përkatëse të votimit në komunat e përcaktuara, si dhe për qendrat e votimit në institucione specifike (si qendrat e paraburgimit, burgjet, qendrat shëndetësore etj.). Koordinimi qendror u mbështet nga Zyra Qendrore e IAP-së në Prishtinë, e cila monitoroi edhe raportimin e mediave. Po ashtu, më 12 tetor 2025, Zyra Qendrore e IAP-së ishte e hapur për pranimin e ankesave.
18. Vëzhgimi i Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura më 12 tetor 2025, nga ekipet monitoruese të IAP-së, u realizua në qendrat e votimit në komunat si në vijim: Prishtinë, Gjiilan, Viti, Klokot, Partesh, Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas, Gjakovë, Deçan, Junik, Pejë, Rahovec, Suharekë, Mamushë, Malishevë, Prizren, Dragash, Istog, Skenderaj, Klinë, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Vushtrri, Zubin Potok, Leposaviç, Zveçan, Kamenicë, Novobërdë, Shtime, Lipjan, Graçanicë, Shtërpçë, Kaçanik, Hani i Elezit dhe Ferizaj. Vëzhgimi u përqendrua gjithashtu në fshatrat e këtyre komunave. Po ashtu, u mbuluan edhe qendra specifike të votimit, si: Burgu i Sigurisë së Lartë, Burgu i Dubravës, Burgu i Smerkonicës, qendrat e paraburgimit në Pejë, Prizren, Gjiilan, Mitrovicë dhe Lipjan, Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), Shtëpia e të Moshuarve në Prishtinë, Qendra për Rehabilitim në Shtime, Qendra Korrektuese në Dubravë, Qendra Korrektuese në Lipjan, Qendra e Shëndetit Mendor, Spitali Rajonal në Pejë, Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë etj.
19. Avokati i Popullit vlerësoi se, në përgjithësi, procesi zgjedhor u zhvillua në mënyrë të qetë dhe demokratike, edhe pse nga ekipet vëzhguese të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) u evidentuan disa parregullsi dhe mangësi që ndikuan në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe krijuan vështirësi në realizimin e së drejtës së votës. Çështjet e evidentuara gjatë monitorimit në disa nga qendrat e votimit ishin si vijon: mungesë e tavolinave ndihmëse; vështirësi në qasjen fizike për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit; vonesa në nisjen e procesit për shkak të mungesës së komisionerëve dhe problemeve të ndryshme teknike; ndryshime të qendrave të votimit për votues të caktuar brenda komunës, si dhe ndryshime të qendrave të votimit duke caktuar disa votues për votim në komuna të tjera, çka shkaktoi konfuzion te votuesit; moszëvendësim me kohë i listave të shënuara/shenjuara nga votuesit; si dhe mungesë e alfabetit Brail.
20. Të gjeturat specifike:
 - 1) Mungesë e formularit për votimin e kryetarit: në Qendrën e Votimit nr. 1702, në Shkollën “Vaso Pashë Shkodrani”, nuk u dërgua fare formulari për votimin e kryetarit. Për këtë çështje u njoftua KQZ-ja, mirëpo gjendja nuk ndryshoi.
 - 2) Personat e paraburgosur në qendrat korrektuese, të pranuar në dhjetë ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, nuk figuronin në listat e KQZ-së, dhe rrjedhimisht u privuan nga e drejta për të votuar.
 - 3) Në qendrat e votimit nr. 3801/01 dhe 3801/02 në Mitrovicë Veriore u evidentuan raste të zhvendosjes së votuesve në lista të komunave të tjera (p.sh. transferimi i votuesve nga Mitrovica në Istog, edhe pse nuk ishin banorë të asaj zone).

Vëzhgimi i Zgjedhjeve Lokale - Raundi i Dytë, të mbajtura më 9 nëntor 2025

21. Procesi i vëzhgimit të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë komunash, të mbajtura më 9 nëntor 2025, u realizua nga stafi i IAP-ja përmes një strukture të koordinuar të ekipeve monitoruese me mbulim të gjerë gjeografik dhe institucional. Ky proces u mbështet nga 23 ekipe të koordinuara monitoruese të zyrtarëve të IAP-së, të cilët mbuluan vëzhgimin në qendrat e votimit nëpër komuna, si dhe në qendrat e votimit në institucionet specifike (si qendrat e paraburgimit, burgjet, qendrat shëndetësore etj.). Koordinimi qendror u mbështet nga Zyra Qendrore e IAP-së në Prishtinë, e cila monitoroi edhe raportimin e mediave. Po ashtu, më 12 tetor 2025, Zyra Qendrore e IAP-së ishte e hapur për pranimin e ankesave fizike, si dhe përmes linjës telefonike. Megjithëse nuk morëm ndonjë ankesë.
22. Vëzhgimi i Zgjedhjeve Lokale për kryetar komune në raundin e dytë, të mbajtura më 9 nëntor 2025, u realizua nga ekipet monitoruese të IAP-së në qendrat e votimit në komunat si në vijim: Prishtinë, Prizren, Dragash, Fushë Kosovë, Obiliq, Gjakovë, Junik, Viti, Kllokot, Gjilan, Kaçanik, Klinë, Mitrovicë e Jugut, Vushtrri, Pejë, Rahovec, Suharekë dhe Mamushë. Vëzhgimi u përqendrua gjithashtu në fshatrat e këtyre komunave dhe përfshiu qendrat specifike të votimit, si: Burgu i Dubravës, Burgu i Sigurisë së Lartë, Burgu i Smrekonicës, Burgu i Mitrovicës, qendrat e paraburgimit në Prishtinë dhe Lipjan, Qendra për Rehabilitim në Shtime dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK).
23. Edhe pse në përgjithësi vlerësohet se procesi zgjedhor i raundit të dytë të Zgjedhjeve Lokale u zhvillua në mënyrë të qetë dhe demokratike, ekipet vëzhguese të IAP-së gjatë monitorimit evidentuan disa parregullsi dhe mangësi në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Disa çështje u evidentuan gjithashtu nga raportimet mediale.
24. Edhe pse tashmë është konstatuar se në vendvotime respektohet e drejta për qasje të papenguar dhe të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, ekipet e IAP-së evidentuan në disa qendra mangësi të tilla, si: mungesë e pjerrinave, vendvotime të vendosura në kate të larta pa ashensor, si dhe objekte shkollore të vjetra që nuk ofrojnë qasje të lehtësuar. Këto mangësi u evidentuan në komunat: Prishtinë, Gjakovë, Klinë dhe Mitrovicë.
25. Po ashtu, vërehet se tashmë i jepet rëndësi respektimit të së drejtës së personave të verbër për pjesëmarrje të barabartë në procesin zgjedhor, përmes sigurimit të alfabetit Brail. Megjithatë, ekipet e IAP-së evidentuan mangësi të tilla, si: mungesë e fletëvotimeve në alfabetin Brail, ose mbajtja e tyre vetëm te menaxheri i qendrës dhe jo në vendvotim.
26. Gjetja më e përsëritur dhe më problematike në të gjitha raportet lidhet me votimin me asistencë. U konstatua se: Udhëzuesi zyrtar i KQZ-së për votimin me asistencë u shpërnda vetëm në ditën e zgjedhjeve; votimi me asistencë u lejua vetëm me dëshmi mjekësore, duke përjashtuar persona të moshuar që nuk ishin në gjendje të votonin vetë, si dhe persona që nuk dinin shkrim-lexim. Po ashtu, u evidentuan praktika të ndryshme nga një qendër në tjetrën, duke krijuar pasiguri për komisionerët dhe votuesit.
27. Për sa i përket pjesëmarrjes së grave, në përgjithësi u vërejt një pjesëmarrje e kënaqshme e tyre si në trupat menaxhuese, ashtu edhe si vëzhguese dhe votuese. Përjashtime të izoluara u evidentuan në disa qendra, ku nuk pati fare përfaqësim të grave në trupat

zgjedhorë.

28. Procesi i votimit në qendrat e paraburgimit dhe institucionet korrektuese u zhvillua në përgjithësi pa incidente. U evidentuan mospërputhje mes listave të burgjeve dhe listave të KQZ-së, persona që nuk figuronin në lista, persona me dokumente identifikimi të skaduar, si dhe raste refuzimi për të votuar. Në disa institucione shëndetësore dhe sociale, ekipet mobile nuk shkuan për shkak të mungesës së kërkesës paraprake nga institucionet përkatëse.
29. Në disa raste u konstatua mungesë e punëtorëve teknikë, të cilët u detyruan të paraqiteshin pa kompensim financiar. Në disa qendra u vërejt mungesë e komisionerëve, pa zëvendësim nga KQZ-ja. Në shumë qendra nuk pati tavolina ndihmëse, gjë që shkaktoi konfuzion te votuesit, radhë dhe vonesa, si dhe nevojë për angazhim shtesë të komisionerëve. Në disa qendra ku tavolina K-Voto ishte vendosur, u vlerësua si ndihmë shumë e dobishme.

Vëzhgimi i Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 28 dhjetor 2025

30. Vëzhgimi i Zgjedhjeve Qendrore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025, u realizua nga ekipet monitoruese të IAP-së në qendrat e votimit nëpër komuna, si dhe në institucione të veçanta, me qëllim garantimin e respektimit të së drejtës për votë, veçanërisht për kategoritë e cënueshme të votuesve dhe për personat që votojnë në kushte të veçanta.
31. Procesi i vëzhgimit të Zgjedhjeve Qendrore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025, u realizua nga stafi i IAP-së përmes një strukture të organizuar dhe të koordinuar të ekipeve monitoruese, me mbulim të gjerë gjeografik dhe institucional në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtij procesi, IAP-ja angazhoi gjithsej 19 ekipe monitoruese, të cilat realizuan vëzhgimin e procesit të votimit në qendrat e votimit nëpër komuna, si dhe në qendrat e votimit të vendosura në institucione specifike, përfshirë qendrat e paraburgimit, institucionet korrektuese (burgjet), institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera ku votojnë kategori të veçanta të votuesve.
32. Koordinimi qendror i procesit të vëzhgimit u mbështet nga Zyra Qendrore në Prishtinë, e cila shërbeu si pikë koordinimi për ekipet në terren, ndoqi raportimet e mediave lidhur me procesin zgjedhor dhe siguroi komunikim të vazhdueshëm ndërinstitutional. Gjatë ditës së zgjedhjeve, Zyra Qendrore ishte e hapur për pranimin e ankesave, si fizikisht, ashtu edhe përmes linjës telefonike dhe mjeteve elektronike të komunikimit.
33. Qendrat e votimit që u vëzhguan nëpër komunat e vendit, përfshirë zona urbane dhe rurale, ishin: Prishtinë, Gjakovë, Deçan, Pejë, Klinë, Vushtrri, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Skenderaj, Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan, Gjilan, Viti, Klllokot, Partesh, Novobërdë, Kamenicë, Ranillug, Rahovec, Suharekë, Mamushë, Malishevë, Prizren, Dragash, Ferizaj, Shtërpçë, Kaçanik, Hani i Elezit, Graçanicë, Janjevë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Istog. Përveç qendrave të zakonshme të votimit, IAP-ja i kushtoi vëmendje të veçantë votimit të grupeve të cënueshme, duke përfshirë institucionet korrektuese dhe të paraburgimit: Qendra e Paraburgimit në Prishtinë, Qendra e Paraburgimit në Pejë, Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë, Burgu i Dubravës, Burgu i Smrekonicës dhe institucionet e tjera të paraburgimit dhe burgjet në

zona të ndryshme, si dhe institucionet shëndetësore dhe sociale, përfshirë Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Qendrën për Rehabilitim Psikiatrik dhe Shtëpitë për Përkujdesje të të Moshuarve.

34. Sipas raportimeve të ekipeve vëzhguese, procesi dhe mbarëvajtja e votimit në përgjithësi u vlerësuan si të rregullta, të lira, të qeta dhe demokratike. Në disa raste, ku ekipet në zgjedhjet paraprake evidentuan cenim të qasjes së kufizuar, vendvotimet në zgjedhjet në fjalë u zhvendosën në katin përdhes, për t'i përmirësuar problematikat e zgjedhjeve të mëparshme. Megjithatë, ekipet vëzhguese të IAP-së gjatë monitorimit evidentuan disa mangësi në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Mangësitë e evidentuara janë si më poshtë:
1. Në një numër qendrash votimi, qasja fizike për persona me aftësi të kufizuara ishte e kufizuar, veçanërisht në objektet me vendvotime në kate të sipërme pa ashensor.
 2. Mungesa e fletëvotimeve në alfabetin Brail është evidentuar në disa qendra votimi.
 3. Mungesë e tavolinës ndihmëse/orientuese për votuesit.
 4. Në disa qendra votimi mungonte shenja ose numri identifikues i qendrës së votimit në hyrje.
 5. Në disa qendra të votimit janë raportuar ndërprerje të shkurtra të energjisë elektrike (të zgjidhura shpejt).
 6. Mungesë e ngrohjes në disa qendra votimi.
 7. Mungesë e komisionerëve (janë zëvendësuar pas njoftimit të KQZ-së).
 8. Disa komisionerë fillimisht nuk kanë pasur kartela identifikuese (çështja është zgjidhur më vonë).
 9. Gjatë monitorimit u konstatuan kufizime në ushtrimin e votimit me asistencë, për shkak të moslejimit të tij/saj pa dëshmi mjekësore, përfshirë edhe rastet e personave analfabetë.
 10. Është vlerësuar zbatim jo i njëtrajtshëm i rregullave për votimin me asistencë, ku në disa vendvotime votuesit janë kthyer pa votuar për shkak të mungesës së raportit përkatës, ndërsa në vendvotime të tjera asistenca është lejuar edhe pa dokumentacion përkatës, bazuar në vlerësimin e komisionerëve. Kjo praktikë ka prekur veçanërisht votuesit që nuk dinë shkrim-lexim dhe ka reflektuar paqartësi në zbatimin e Udhëzuesit.

Personat e privuar nga liria dhe institucionet e veçanta

Procesi i votimit në qendrat e paraburgimit dhe institucionet korrektuese u zhvillua në mënyrë të rregullt në aspektin organizativ. Megjithatë, u identifikua një problem serioz lidhur me fshehtësinë e votës, pasi fletëvotimet vendoseshin në zarfe me numër rendor të votuesit, ndërsa zarfet përmbanin të dhëna identifikuese, duke krijuar mundësi për identifikimin e votës. Në institucionet shëndetësore dhe psikiatrike, disa persona nuk votuan për shkak të mungesës së stafit për asistencë, ndërsa persona me zotësi veprimi lejoheshin të votonin vetëm me kujdestar ligjor.

Analiza ligjore përkitazi me të gjeturat

35. Siç është shtjelluar më lart, IAP-ja vëzhgoi tri proceset e fundit zgjedhore në vend: Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale për

Kryetarë Komunash të mbajtura më 9 nëntor 2025, si dhe Zgjedhjet Qendrore për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 28 dhjetor 2025. Vëzhgimi u realizua përmes ekipeve të koordinuara monitoruese të zyrtarëve të IAP-së, me mbulim të gjerë gjeografik nëpër komuna dhe në institucione specifike ku votojnë kategori të veçanta të votuesve, përfshirë qendrat e paraburgimit, institucionet korrektuese dhe institucionet shëndetësore dhe sociale.

36. Në përgjithësi, sipas vëzhgimit të tri proceseve zgjedhore në terren, nga ekipet e akredituara të IAP-së u vërejt se procesi i votimit u zhvillua i qetë, demokratik dhe me rregull. Por, duke u bazuar në të gjeturat gjatë vëzhgimit, në disa qendra u evidentuan mangësi të përsëritura që ndikuan në ushtrimin efektiv të së drejtës së votës, të cilat në vijim pasqyrohen të përmbledhura nga vëzhgimi i tri palë zgjedhjeve:

- i) Qasje e kufizuar fizike për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, si pasojë e vendotimeve të vendosura në kate të larta pa ashensor dhe të objekteve shkollore të vjetra.
- ii) Mungesë ose vendosje jo e duhur e tavolinave ndihmëse/orientuese shkaktoi konfuzion të votuesit, radhë dhe vonesa në disa qendra votimi.
- iii) Mungesa e materialeve zgjedhore në raste të izoluara, përfshirë mungesën e formularëve për votim dhe mungesën ose shpërndarjen jo të njëtrajtshme të fletëvotimeve në alfabetin Brail.
- iv) Vonesa në hapjen e disa qendrave të votimit për shkak të mungesës së komisionerëve, problemeve teknike dhe moszëvendësimit të tyre me kohë nga autoritetet zgjedhore.
- v) Probleme serioze lidhur me votimin me asistencë, për shkak të zbatimit jo të njëtrajtshëm të rregullave, kërkesës për dëshmi mjekësore dhe përjashtimit të personave analfabetë dhe të moshuar.
- vi) Zhvendosje të qendrave të votimit për votues të caktuar, përfshirë transferime në komuna të tjera pa lidhje reale banimi, duke shkaktuar konfuzion dhe pamundësi për të ushtruar të drejtën e votës.
- vii) Rrezikim i fshehtësisë së votës në disa institucione korrektuese, për shkak të përdorimit të zarfeve që përmbanin të dhëna identifikuese ose numra rendorë të lidhur me votuesin.
- viii) Pamundësim i realizimit të së drejtës së votimit në disa institucione shëndetësore dhe sociale, për ekipet mobile, për shkak të mungesës së kërkesës paraprake ose të stafit për asistencë.
- ix) Mungesë e punëtorëve teknikë dhe e stafit mbështetës në disa qendra votimi, si dhe disa që ishin angazhuar pa kompensim financiar.
- x) Mangësi infrastrukturore dhe teknike në disa qendra votimi, përfshirë mungesën e ngrohjes, ndërprerjet e shkurtra të energjisë elektrike dhe mungesën e shenjimit identifikues.

Lëshimet e listuara më lart paraqesin nevojën për ndërmarrjen e veprimeve nga ana e organeve kompetente, jo vetëm për përmirësime strukturore, por edhe udhëzuese, me

qëllim garantimin e ushtrimit të barabartë dhe efektiv të së drejtës së votës për të gjithë qytetarët, pa dallim.

37. E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur garantohet me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton parimet e votës personale, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë, si dhe detyrimin e institucioneve për të mbështetur pjesëmarrjen demokratike. Neni 45 i Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] përcakton: *“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.”*
38. Përkritazi me të gjeturat se një numër i konsiderueshëm vendvotimesh janë vendosur në kate të larta të objekteve shkollore, pa pajisje funksionale si ashensorë, gjë që e bën qasjen fizike tejet të vështirë për personat me aftësi të kufizuara dhe për personat e moshuar, duhet theksuar se vendosja e vendvotimeve në objekte të vështira për t'u qasur fizikisht, pa masa alternative efektive, përbën një pengesë strukturore, pasi prek në mënyrë disproporcionale personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, edhe pse masa në dukje është neutrale. Rregullorja nr. 05/2024, që rregullon çështjen e themelimit dhe menaxhimit të Qendrave të Votimit, në nenin 9, paragrafi 1, lidhur me vendndodhjen e vendvotimeve, përcakton: *“Vendvotimet vendosen duke filluar në katin përdhesë, në një vend të përshtatshëm për hyrje-dalje, për t'u mundësuar votuesve të krijojnë rresht dhe të qëndrojnë në të, dhe kur është e mundur, vendi për hyrje-dalje të jetë i rrafshët, ashtu që personat me aftësi të kufizuara të mund të hyjnë dhe të dalin në mënyrë të papenguar.”*
39. Pra, integrimi i qasjes së papenguar është paraparë në Rregulloren nr. 05/2024, në nenin 9, paragrafi 1, si dhe në nenin 2, paragrafi 1, të Rregullores nr. 12/2024 - Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, të cilat përcaktojnë qartë detyrimin që vendvotimet të vendosen në mënyrë që të sigurohet qasje e përshtatshme dhe e papenguar për të gjithë votuesit, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe ata me nevoja të veçanta. Konkretisht, ato parashohin që vendvotimet të vendosen duke filluar nga kati përdhes, në hapësira të përshtatshme për hyrje dhe dalje, të cilat mundësojnë krijimin dhe qëndrimin në rresht të votuesve, si dhe, kurdo që është e mundur, hyrja dhe dalja të jenë të rrafshëta, me qëllim që personat me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta të kenë mundësi të hyjnë dhe të dalin në mënyrë të lirë, të sigurt dhe pa pengesa fizike, duke garantuar kështu ushtrimin e barabartë dhe efektiv të së drejtës së votës.
40. Sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), e drejta për zgjedhje të lira dhe demokratike nuk kufizohet vetëm në ekzistencën formale të votimit, por kërkon që shtetet të garantojnë ushtrimin praktik dhe efektiv të kësaj të drejte. Në rastin Toplak dhe Mrak kundër Sllovenisë (2021), që kishte të bënte me dy persona përdorues të karrocave, të cilëve iu pamundësua qasja në qendrat e votimit gjatë një referendumi, GjEDNj-ja konstatoi se Sllovenia kishte shkelur të drejtat e tyre për shkak të mungesës së vendvotimeve të qasshme ose të teknologjive ndihmëse, duke theksuar se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për qasje adekuate për të garantuar shprehjen e lirë dhe të fshehtë të vullnetit të tyre zgjedhor.

41. Lidhur me të gjeturat përkitazi me të drejtën e fshehtësisë së votës, gjatë monitorimit, ekipi i IAP-së vërejtë se në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë dhe në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, votuesit obligoheshin ta vendosnin fletëvotimin në një zarf, në të cilin shënohej numri rendor i votuesit sipas listës së KQZ-së, duke përfshirë emrin, mbiemrin, numrin personal të votuesit, si dhe nënshkrimin. Shënimi i numrit rendor në zarf, në kombinim me të dhënat në listën e votuesve, mundëson identifikimin e votuesit dhe, rrjedhimisht, subjektin politik për të cilin votoi. Ligji nr. 08/L-228, në nenin 4, paragrafi 1.3, përcakton: *“Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.”*
42. Praktika e obligimit të votuesve që fletëvotimi të vendoset në zarfe të shënuara me të dhëna identifikuese përbën një cenim serioz të parimit të fshehtësisë së votës, pasi krijon mundësi reale për identifikimin e votuesit dhe të vullnetit të tij elektoral. Kjo praktikë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me garancitë ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 08/L-228, i cili garanton lirinë dhe fshehtësinë e votës dhe ndalon çdo formë të zbulimit apo kushtëzimit të vullnetit zgjedhor, duke vënë në pikëpyetje integritetin e procesit zgjedhor dhe respektimin e standardeve demokratike.
43. Meqenëse gjatë vëzhgimit të procesit zgjedhor në disa raste është evidentuar mungesa e shenjave orientuese dhe e shënimit të numrave të qendrave të votimit në hyrje, Avokati i Popullit rikujton se Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 85, obligon që qendrat dhe vendvotimet të jenë të pajisura me shenja informuese të qarta dhe të dukshme për orientimin e votuesve. Po ashtu, Rregullorja Zgjedhore nr. 12/2024 përcakton detyrimin e KQZ-së për përgatitjen e shenjave orientuese, si dhe obligimin e menaxherit të QV-së dhe KVV-së për vendosjen e tyre në hapësira të dukshme, me qëllim garantimin e informimit dhe orientimit të saktë të votuesve.
44. Po ashtu, është evidentuar mungesa e tavolinave ndihmëse, e materialeve informuese dhe e personelit të trajnuar për orientimin e votuesve, si dhe mungesa e praktikave të unifikuara për vendosjen e tyre në qendrat e votimit. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vëren se Rregullorja Zgjedhore nr. 05/2024 obligon vendosjen e së paku një tavoline ndihmëse në hyrjen e çdo qendre votimi, të pajisur me lista votuesish, formularë ankesash dhe personel përgjegjës për orientimin dhe informimin e votuesve, si dhe për raportimin e pjesëmarrjes dhe mbarëvajtjes së procesit, nën përgjegjësinë e menaxherit të QV-së.
45. Edhe pse e drejta e votës u garantohet në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarëve, ekipet monitoruese të IAP-së konstatuan mungesë të praktikës së unifikuar për sa i përket sigurimit të fletëvotimeve në alfabetin Brail në qendrat e votimit, ku në një numër të konsiderueshëm të QV-ve këto fletëvotime munguan. Në këtë kontekst, Rregullorja Zgjedhore nr. 05/2024 obligon që çdo qendër votimi të pajiset me shabllone në alfabetin Brail dhe me komisionerë të trajnuar për asistimin e votuesve të verbër, me qëllim garantimin e ushtrimit të pavarur dhe të barabartë të së drejtës së votës. Kjo rregullore, në paragrafin 5 të nenit 8, përcakton: *“Në çdo QV duhet të ketë edhe shabllone me alfabetin e brajl-it dhe KVV të trajnuar për votimin e personave të verbër, të cilët do t’u shërbejnë votuesve të verbër në atë QV.”*
46. Përkitazi me të gjeturat lidhur me mungesën e materialeve zgjedhore në raste të izoluara,

ekipet monitoruese të IAP-së në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, në Qendrën e Votimit nr. 1702 në shkollën “Vaso Pashë Shkodrani”, Pejë, evidentuan mungesë të formularit për votimin e kryetarit. Për disa orë, gjatë qëndrimit të ekipit të IAP-së në vëzhgim, formulari nuk u soll në këtë qendër të votimit, për të cilën u njoftua KQZ-ja, dhe deri në mesditë nuk u ndërmorën veprime, duke e bërë të pamundur votimin për votuesit. Nga aspekti juridik, mungesa e formularit për votimin e kryetarit në Qendrën e Votimit nr. 1702 gjatë Zgjedhjeve Lokale të 12 tetorit 2025 përbën një cenim serioz të së drejtës për të votuar dhe të parimit të zgjedhjeve të lira dhe efektive. Legjislacioni zgjedhor obligon KQZ-në që të sigurojë në kohë dhe në mënyrë të plotë të gjitha materialet zgjedhore të nevojshme për ushtrimin e së drejtës së votës, ndërsa dështimi për t'i dorëzuar ato, pavarësisht njoftimit të bërë, rezultoi në pamundësimin faktik të votimit për një pjesë të votuesve. Një situatë e tillë është në kundërshtim me parimet themelore të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet Lokale, sipas të cilave vota duhet të jetë e lirë, e barabartë dhe e garantuar për çdo qytetar, si dhe me obligimet e KQZ-së për administrimin e rregullt dhe funksional të procesit zgjedhor, duke vënë në pikëpyetje efektivitetin e mbrojtjes të së drejtës zgjedhore në këtë rast.

47. Ekipet vëzhguese të IAP-së, në Qendrat Korrektuese, evidentuan se personat e paraburgosur të pranuar në 10 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve nuk patën mundësinë të votonin, pasi nuk figuronin në listat e KQZ-së. Po ashtu, cenimi i së drejtës zgjedhore është evidentuar edhe në disa institucione shëndetësore dhe sociale, ku ekipet mobile nuk realizuan votimin për shkak të mungesës së kërkesës paraprake ose të stafit për asistencë.
48. Nga këndvështrimi i parimeve themelore të përcaktuara në Ligjin nr. 08/L-228, gjetjet e ekipeve vëzhguese të IAP-së nxjerrin në pah mangësi serioze në garantimin e ushtrimit efektiv të së drejtës së votës. Mospërfshirja në listat e KQZ-së e personave të paraburgosur të pranuar në 10 ditët e fundit para zgjedhjeve rezultoi në përjashtim faktik të tyre nga procesi zgjedhor, duke cenuar parimin e votës së përgjithshme dhe të barabartë, sipas të cilit çdo shtetas me të drejtë vote duhet të ketë mundësi reale për ta ushtruar atë, përveç rasteve të kufizimit me vendim gjyqësor. Në mënyrë të ngjashme, mosrealizimi i votimit në disa institucione shëndetësore dhe sociale nga ekipet mobile, për shkak të mungesës së kërkesës paraprake ose të stafit për asistencë, tregon mungesë të masave pozitive nga autoritetet zgjedhore për të siguruar qasje të barabartë dhe mosdiskriminuese në votim për kategori të cënueshme të votuesve. Këto praktika bien ndesh edhe me parimin e lirisë së votës, pasi pengesat procedurale dhe organizative kufizuan ushtrimin e vullnetit të lirë zgjedhor, si dhe me detyrimin e institucioneve zgjedhore që zgjedhjet të administrohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe efektive, në përputhje me standardet demokratike dhe ligjore në fuqi.
49. Përkitazi me të gjeturat se pati vonesa në hapjen e disa qendrave të votimit për shkak të mungesës së komisionerëve, problemeve teknike dhe moszëvendësimit me kohë nga autoritetet zgjedhore, gjithashtu u evidentua mungesa e punëtorëve teknikë dhe e stafit mbështetës, si dhe e atyre të angazhuar pa kompensim financiar. Në disa qendra votimi u konstatuan mangësi infrastrukturore dhe teknike, përfshirë mungesë ngrohjeje, ndërprerje të shkurtra të energjisë elektrike dhe mungesë shënjimi identifikues. Nga perspektiva juridike, Avokati i Popullit thekson se këto të gjetura paraqesin cenim të parimeve themelore të administrimit të zgjedhjeve, të përcaktuara në Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në Ligjin nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale. Edhe pse këto

mangësi u konstatuan në vende të izoluar, ato tregojnë probleme strukturore dhe organizative në administrimin e procesit zgjedhor, të cilat duhet të adresohen në mënyrë që të parandalohet përsëritja e tyre në të ardhmen.

50. Për sa u përket të gjeturave lidhur me rastet e ndryshimit ose zhvendosjes së qendrave të votimit për votues të caktuar, përfshirë transferime në komuna të tjera pa lidhje reale me vendbanimin, duke shkaktuar konfuzion dhe pamundësi për të votuar, Avokati i Popullit thekson se kjo praktikë, veçanërisht transferimet e votuesve në komuna të tjera, vendosi votuesit në një pozitë të pafavorshme krahasuar me të tjerët dhe krijoi pengesa objektive për ushtrimin efektiv të së drejtës së votës. Në këtë kontekst, Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 8, obligon që caktimi i qendrës së votimit të bazohet në të dhënat e sakta dhe të përditësuara të Regjistrit Qendror Civil dhe të jetë i lidhur drejtpërdrejt me vendbanimin e votuesit, me qëllim garantimin e qasjes reale dhe praktike në votim. Zhvendosja e votuesve në komuna të tjera, pa arsye të arsyeshme dhe pa informim efektiv paraprak, cenon gjithashtu parimin e lirisë së votës, pasi konfuzioni i shkaktuar dhe distanca e pajustificuar dekurajojnë ose pamundësojnë ushtrimin e vullnetit zgjedhor.
51. Ekipet vëzhguese të IAP-së gjatë monitorimit evidentuan kryesisht mangësi dhe probleme lidhur me të drejtën për votim me asistencë për personat që hasin në vështirësi në shkrim dhe lexim, kryesisht persona të moshuar. Edhe pse Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk e parasheh shprehimisht këtë të drejtë, ai as nuk e kufizon atë. Duke marrë parasysh se një kategori e konsiderueshme e personave të moshuar ka vështirësi në shkrim dhe lexim, mosofrimi i ndihmës asistente sipas kërkesës dhe zgjedhjes së tyre bën të pamundur ushtrimin e së drejtës për të votuar. Në këto situata u evidentuan zbatim jo i njëtrajtshëm i rregullave për shkak të mungesës së informimit dhe udhëzimeve të qarta, efektive dhe të standardizuara. Praktikrat e konstatuara gjatë monitorimit tregojnë se mungesa e rregullave dhe udhëzimeve të standardizuara rezultoi në trajtim të pabarabartë të votuesve në qendra të ndryshme votimi. Për këtë arsye, KQZ-ja, në ushtrim të kompetencave të saj kushtetuese dhe ligjore për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, ka obligim pozitiv që të parashohë dhe të zhvillojë rregulla, procedura dhe praktika të përshtatshme, të cilat mundësojnë ushtrimin efektiv të së drejtës së votës edhe për personat me vështirësi në shkrim dhe lexim. Avokati i Popullit vlerëson se mungesa e një qasjeje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse nga ana e KQZ-së rrezikon përjashtimin faktik të një kategorie të konsiderueshme të votuesve nga procesi zgjedhor. Prandaj, zhvillimi i rregullave të qarta dhe i praktikave të standardizuara për votimin me asistencë për personat që nuk dinë të shkruajnë e lexojnë paraqitet si domosdoshmëri ligjore dhe demokratike, në funksion të garantimit të votës së përgjithshme, të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.
52. Ekipet vëzhguese të IAP-së po ashtu hasën në gjetje të moslejimit të personave me aftësi të kufizuara për të votuar për shkak të mungesës së dëshmisë përkatëse. Paragrafi 5, i nenit 89 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton: *“Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi, me kusht që personi që ndihmon është votues në qendrën e njëjtë të votimit me votuesin. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV-së ose vëzhgues i akredituar, përjashtimisht për anëtarët e ngushtë të familjes. Për këtë lloj të votimit, KQZ do t'i caktojë kriteret me rregullën zgjedhore.”* Edhe pse ligji i jep KQZ-së kompetencën për t'i

përcaktuar kriteret për votimin me asistencë përmes rregulloreve zgjedhore, gjetjet tregojnë se në praktikë nuk pati qartësi të mjaftueshme lidhur me dokumentet konkrete që kërkohen dhe me fazën e procesit zgjedhor në të cilën ato duhen paraqitur. Kjo mungesë e qartësimit normativ dhe udhëzues shkaktoi zbatim jo të njëtrajtshëm të rregullave nëpër qendra të ndryshme votimi, duke krijuar pasiguri juridike dhe trajtim të pabarabartë të votuesve me aftësi të kufizuara. Si pasojë, në disa raste, këtyre personave u është pamundësuar votimi, jo për shkak të mungesës të së drejtës ligjore, por për shkak të mungesës së dokumenteve që nuk janë të parashikuara qartë. Avokati i Popullit vlerëson se një praktikë e tillë bie ndesh me parimin e votës së lirë dhe të barabartë, si dhe me ndalimin e çdo forme të pengimit të votimit, të garantuar nga nenet 4 dhe 89 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Ankesat e pranuar në Institucionin e Avokatit të Popullit

53. Në lidhje me ankesat që pranoi IAP-ja, ankuesit u ankuan për çështjet në vijim:

- i) mohimi i votimit me asistencë për persona të moshuar që nuk dinë shkrim-lexim;
- ii) mossigurimi i materialit për votim (zarfi për votim) për votuesit jashtë vendit;
- iii) parregullsi në procesin e votimit dhe të numërimit të votave në Zgjedhjet Lokale të 12 tetorit 2025 në Komunën e Hanit të Elezit;
- iv) cenimi i të drejtave për votim të personave me aftësi të kufizuara përmes Udhëzuesit të KQZ-së për Votimin me Asistencë.

54. Në lidhje me moslejimi i votimit me asistencë për personat e moshuar që nuk njohin shkrim dhe lexim, kjo çështje u trajtua në paragrafin 51 të këtij raporti.

55. Përkitazi me mungesën e sigurimit të materialit zgjedhor (zarfi për votim) për votuesit e diasporës: Nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe standardeve demokratike, mospranimi i materialit zgjedhor nga votuesit e regjistruar jashtë Kosovës cenon efektivitetin e së drejtës së votës, duke e reduktuar atë në një të drejtë formale, pa mundësi reale ushtrimi. Mungesa e dërgimit ose e pranimi të materialit zgjedhor nuk mund t'i atribuohet votuesit, për aq kohë sa ai ka përmbushur obligimet procedurale për regjistrim, por bie në përgjegjësinë administrative të KQZ-së për organizimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen efektive të procesit. Duke marrë parasysh se raste të ngjashme janë raportuar edhe nga mediat, Avokati i Popullit vlerëson se KQZ-ja duhet të verifikojë në mënyrë të detajuar ngecjet dhe mangësitë e procesit, në mënyrë që lëshimet teknike në procedurë ndaj votuesve të diasporës të mos ndikojnë në humbjen e së drejtës së tyre për të votuar.

56. Përkitazi me pretendimet për cenimin e të drejtave të votimit të personave me aftësi të kufizuara përmes Udhëzuesit të KQZ-së për Votimin me Asistencë, kjo çështje u trajtua në paragrafin 52 të këtij raporti.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

57. Avokati i Popullit, duke u bazuar në të gjeturat e paraqitura në këtë Raport, konstaton si në vijim:

- a) Avokati i Popullit konstaton se, edhe pse proceset zgjedhore të vëzhguara u zhvilluan përgjithësisht në mënyrë të qetë dhe demokratike, gjatë tri proceseve u evidentuan mangësi të përsëritura strukturore, organizative dhe procedurale, të cilat

ndikuan negativisht në ushtrimin praktik dhe efektiv të së drejtës së votës për kategori të caktuara të votuesve, në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me parimet themelore të legjislacionit zgjedhor.

- b) Avokati i Popullit konstaton se, mungesa e qasjes fizike të përshtatshme në disa qendra votimi, mungesa ose vendosja jo e duhur e shënjitimit dhe tavolinave ndihmëse, mungesa e materialeve zgjedhore (përfshirë fletëvotimet në alfabetin Brail), si dhe vonesat në hapjen e qendrave të votimit për shkak të mangësive në staf dhe infrastrukturë, përbëjnë pengesa objektive që cenojnë parimet e votës së barabartë, të lirë dhe të përgjithshme. Këto gjetje tregojnë nevojën për përmirësime sistematike në administrimin e procesit zgjedhor nga autoritetet përgjegjëse.
- c) Avokati i Popullit konstaton se praktikën e evidentuara lidhur me votimin me asistencë, përfshirë kërkesat e paqarta ose të pajustificuara për dëshmi mjekësore, përjashtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe personave të moshuar që nuk dinë shkrim e lexim, si dhe zbatimin jo të njëtrajtshëm të rregullave në qendrat e votimit, rezultuan në trajtim të pabarabartë të votuesve dhe, në raste konkrete, në pamundësim faktik të ushtrimit të së drejtës së votës. Kjo gjendje bie në kundërshtim me nenet 4 dhe 89 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.
- d) Avokati i Popullit konstaton se rrezikimi i fshehtësisë së votës në disa institucione korrektuese, për shkak të përdorimit të zarfeve me të dhëna identifikuese, si dhe mosrealizimi i votimit për kategori të veçanta të votuesve, përfshirë personat e paraburgosur të sapoprانuar, votuesit në institucione shëndetësore dhe sociale, si dhe votuesit nga diaspora për shkak të mospranimi të materialit zgjedhor, përbëjnë një cenim serioz të standardeve demokratike dhe efektivitetit të së drejtës së votës. Kjo gjendje tregon nevojën që KQZ-ja dhe institucionet përkatëse të ndërmarrin masa të qarta, të standardizuara dhe gjithëpërfshirëse për të garantuar ushtrimin real dhe të barabartë të së drejtës së votës në proceset e ardhshme zgjedhore.

Duke u bazuar në rrethanat e cekura më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “[...] *ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”, si dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, i

REKOMANDON

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

- *T’i standardizojë edhe më tej dhe t’i zbatojë në mënyrë të unifikuar të gjitha elementet minimale të informimit dhe orientimit në të gjitha qendrat e votimi.*
- *Të ndërmarrë masa konkrete që në të ardhmen të sigurojë qasje fizike të plotë dhe të papenguar në të gjitha qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara dhe për personat e moshuar.*
- *Të garantojë furnizimin e plotë dhe në kohë me materiale zgjedhore, përfshirë formularët përkatës dhe fletëvotimet në alfabetin Brail, si dhe të vendosë mekanizma të menjëhershëm reagimi për rastet e mungesave të papritura, në mënyrë që të shmangët pamundësimi i votimit për votuesit.*

- Të ndërmarrë masa për ruajtjen e fshehtësisë së votës, veçanërisht në institucione korrektuese dhe të paraburgimit, duke eliminuar çdo praktikë që mundëson identifikimin e votuesit përmes zarfeve ose shënjimeve identifikuese.
- T'i rishikojë dhe t'i standardizojë procedurat për votimin me asistencë, duke nxjerrë udhëzime të qarta dhe konkrete për votuesit e kategorive të cënueshme, në mënyrë që të mos u pamundësohet ushtrimi i votës.
- T'i rishikojë mekanizmat për caktimin dhe ndryshimin e listave të votuesve nëpër qendrat e votimit, duke siguruar që ato të bazohen në të dhëna të sakta të Regjistrat Qendror Civil.
- T'i forcojë kapacitetet organizative dhe administrative përmes angazhimit të mjaftueshëm të stafit të trajnuar dhe të kompensuar në mënyrë adekuate, si dhe përmirësimit të kushteve infrastrukturore dhe teknike në qendrat e votimit, përfshirë sigurimin e ngrohjes, energjisë elektrike dhe kushteve minimale të punës.
- T'i rishikojë dhe t'i përmirësojë procedurat për votimin jashtë vendit, duke forcuar mekanizmat e dërgimit dhe konfirmimit të pranimit të materialit zgjedhor, si dhe duke krijuar masa korrigjuese efektive për rastet kur votuesit e regjistruar nuk e pranojnë materialin për votim.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë."), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

